



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.17.1-2017-06

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
FERIZAJT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Ferizajt, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Enver Ramadani, Udhëheqës i ekipit, dhe Fetah Osmani e Hysen Restelica-Anëtarë, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Mujë Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
5 Qeverisja e mirë.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	27
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	30
Shtojca III: Letërkonfirmimi	39

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Ferizajt për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 09/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore, *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, përveç keq-klasifikimit të shpenzimeve në vlerë 434,732€, të cilat për nga natyra i takonin mallrave dhe sherbimeve, mirëpo ishin paguar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale.

Theksimi i çështjes

Pagesat për investime kapitale të bëra përmes vendimeve të gjykatave apo përmbarueseve në vlerë 690,292€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive. Në këtë regjistër nuk ishin përfshirë edhe banesat në pronësi të komunës, të cilat ishin dhënë me qira. Me tutje, llogaritë e arkëtueshme për lejet e ndërtimit në vlerë 446,279€ nuk ishin shpalosur saktë në pasqyrat financiare.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Ferizajt për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion të kualifikuar

Komuna e Ferizajt ka paguar dhe raportuar gabimisht shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 434,732€¹ nga kategoria e investimeve kapitale. Si rrjedhojë, shpenzimet për investime kapitale të raportuara në PFV ishin të mbivlerësuara. Gabimi i raportuar ishte material andaj ne kemi kualifikuar opinionin tonë.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të

¹ Shërbime të telefonit, pastrimit, shërbimet shëndetësore, mirëmbajtja e sinjalistikës në rrugë, etj.

cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është i pavarur nga Komuna dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se:

- 19 pagesa të bëra përmes vendimeve të gjykatave apo përmbarueseve në vlerë 690,292€, nuk ishin regjistruar si pasuri kapitale në regjistrin e pasurive. Gjithashtu banesat në pronësi të komunës, të dhëna me qira, nuk ishin përfshirë në regjistrin e pasurisë dhe në PFV; dhe
- Llogaritë e arkëtueshme nga lejet e ndërtimit në vlerë 446,279€, nuk ishin paraqitur në PFV. Mos prezantimi i tyre ishte si pasojë e mungesës së komunikimit të rregullt në mes të drejtorive komunale. Zyrtari Kryesor Financiar nuk kishte informacion të dokumentuar nga drejtoria e urbanizmit, për kështet e pa inkasuara.

Opinionin ynë nuk është i kualifikuar në lidhje me këto çështje.

Çështjet kyçe të auditimit

Komuna e Ferizajt ishte ballafaquar me shumë konteste gjyqësore gjatë vitit 2017 për të cilat kishte paguar shuma të konsiderueshme të mjeteve. Vetëm nga nëntë mostrat e testuara vlera e pagesave ishte 963,146€ (927,211€ ishte vlera e faturave dhe 35,935€ vlera e taksave përfshirë përmbaruesit privat).

Vonesat në pagesat e obligimeve brenda afatit ligjor, i kanë sjellë komunës shpenzime shtesë lidhur me pagesën e taksave të ndryshme si dhe për përmbaruesit privat.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalsjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Nëse PFV janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar ne MF;
- Nëse Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar me kohë; dhe
- Nëse Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe një kopje tek MF.

Komuna kishte bërë disa gabime në pasqyrat fillestare e të cilat i kishte korigjuar brenda afatit ligjor. Korigjimet ishin bërë në pikat si në vijim:

- Në pasqyrën e dytë - (ekzekutimi i buxhetit), shënimi 12, fillimisht nuk ishin përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve në shumë prej 70,000€; dhe
- Në pasqyrën e dytë - buxheti final - tek dalja e parasë së gatshme, buxheti final ishte prezantuar gabimisht në vlerë 27,393,000€, derisa buxheti final ishte në vlerë 28,338,000€.

Megjithatë, edhe përpos korigjimeve të çështjeve të lartcekura, kanë mbetur edhe disa gabime të cilat i kemi shpalosur te opinionin e auditimit.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në MF, mund të konsiderohet e saktë, më përjashtim të keq klasifikimeve të prezantuara në opinionin e auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për kualifikim të opinionit, si dhe atyre për theksim të çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në raportimin e PVF-ve, përfshirë edhe shpalosjen e tyre. Në këtë aspekt me pas të gjitha shpenzimet duhet të paguhen dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël, bazuar në kërkesat e ligjit të buxhetit. Me tutje të forcohen kontrollet në evidentimin e të gjithë pasurisë si dhe të shpalosjet e tyre në pasqyrat financiare.

Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve 2018 i adreson të gjitha çështjet. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë si dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Për shkak të moszbatimit me konsistencë të rregulloreve, fusha e prokurimit vazhdon të mbetet fusha më shqetësuese, duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para si dhe në vonesat në përfundim të projekteve. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, veçanërisht të të hyrave nga leje ndërtimi. Gjithashtu kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtjshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit sipas projekteve të parapara, menaxhimi i obligimeve të pa paguara, menaxhimi i projekteve kapitale dhe menaxhimi i prokurimit.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	26,480,591	28,338,915	27,058,456	25,258,562	25,128,033
Granti i Qeverisë -Buxheti	21,982,413	22,156,271	22,090,820	21,376,372	21,518,601
Të bartura nga viti paraprak ³	0	1,587,236	1,524,372	729,319	766,119
Të hyrat vetjake ⁴	4,210,678	4,210,678	3,363,343	3,020,666	2,597,871
Donacionet e brendshme	0	78,128	63,215	111,416	179,049
Donacionet e jashtme	0	19,102	16,706	20,789	66,393
Huamarrjet	287,500	287,500	-	-	-

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

³ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,858,324€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme, të hyrave të bartura nga viti paraprak, si dhe i rritjes së aplikuar pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2017, Komuna e Ferizajt ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 27,058,456€, me një përmirësim prej 1% krahasuar me vitin 2016, qe ishte 94%. Ne përgjithësi, komuna ka treguar një nivel të pranueshëm të performancës buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	26,480,591	28,338,915	27,058,456	25,258,562	25,128,033
Pagat dhe Mëditjet	14,347,051	14,586,347	14,514,631	14,323,589	14,016,218
Mallrat dhe Shërbimet	2,947,314	2,952,070	2,812,023	2,993,220	1,466,867
Shërbimet komunale	452,680	453,566	451,290	532,052	433,656
Subvencionet dhe Transferet	599,752	660,746	659,626	659,232	693,127
Investimet Kapitale	8,133,794	9,686,186	8,620,886	6,750,469	8,518,165

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Paga dhe Mëditje – buxheti final është rritur për 239,296€ (173,858€ nga granti i qeverisë, 58,355€ nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak dhe 7,083€ nga donacionet);
- Mallra dhe Shërbime – buxheti final është rritur për 4,756€ (3,378€ nga të hyrat e bartura prej viti paraprak dhe 1,378€ nga donacionet);
- Subvencionet – buxheti final është rritur për 60,990€ (nga të hyrat e bartur prej vitit paraprak); si dhe
- Investimet Kapitale – buxheti final është rritur në raport me buxhetin fillestar për 1,552,392€ (1,464,260€ nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak dhe 88,132€ nga donacionet). Shpenzimet e realizuara për investime kapitale në raport me buxhetin final janë 89%.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna në 2017 ishin në vlerë 3,450,803€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë në shumë prej 1,505,288€, të hyrat nga lejet e ndërtimit 859,366€, taksat administrative 111,658€, të hyrat nga veprimtaritë biznesore 133,270€, të hyrat nga qiraja prej 80,777€ etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	4,210,678	4,210,678	3,450,803	4,199,493	3,511,999
Totali	4,210,678	4,210,678	3,450,803	4,199,493	3,511,999

Komuna e Ferizajt gjatë vitit 2017 ka arritur t'i shfrytëzoj pjesën me të madhe të të hyrat vetjake përfshirë edhe hyrat e bartura nga viti paraprak. Megjithatë, vlen të theksohet se komuna kishte arritur të verifikoj 1/3 e pronave.

Përpos të dhënave të prezantuara në tabelë, komuna kishte edhe të hyra indirekte (dënimet në trafik dhe gjobat) në vlerë 439,199€.

Më poshtë janë listuar mangësitë e identifikuar lidhur me menaxhimin e të hyrave.

Çështja 2 – Lëshimi i vendimeve për leje të ndërtimit pa përfunduar pagesa e plotë e taksave

E gjetura Më Ligjin për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 21, pika 3, është paraparë që aplikuesit i lëshohet leja ndërtimore nëse ka paraqitur dëshmi për pagesën e taksës së lejes ndërtimore. Në pesë raste⁵ ne kemi identifikuar se aplikuesve për leje të ndërtimit ju ka mundur pagesa në këste, përmes një vendimi të lëshuar nga ana e Komunës. Pas pagesës së kështit të I -re ata kanë marrë vendimet e lejeve të ndërtimit, derisa kishin mbetur obligim edhe për dy këste tjera. Shuma e dy kësteve të mbetura si obligim për këta pesë aplikontë ishte 171,164€.

Rreziku Lejimi i pagesës me këste të taksës së lejeve të ndërtimit paraqet rrezik të mos inkasimit me kohë të të hyrave bazuar në lejet e lëshuara të ndërtimit.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të ndërmarrë veprime për ta rishikuar vendimin për mundësinë e pagesave me këste, dhe të sigurojë se lejet e ndërtimit lëshohen vetëm pas përfundimit të pagesave të taksave në përputhje me legjislacionin për ndërtimet.

⁵ Nr. i protokollit: 04-351/01-0058499/17; 04-351/01-0101543/17; 04-351/02-0108176/17; 04-351/02-0113604/17 dhe 04-351/020111406/17.

Çështja 3 - Mos kryerja e obligimeve (qirasë) nga shfrytëzuesit e pronës komunale

E gjetura Komuna ka dhënë me qira prona komunale për shfrytëzim të përkohshëm (me qira), mirëpo, nuk kishte arritë të inkasojë të hyrat në përputhje me kontraktimin për to.

Obligimet kontraktuale për vetëm tetë qiramarrës, të cilët ishin mostër e jona ishin 123,016€, derisa pagesat e realizuara për ta ishin 27,718€ ose vetëm 23%. Komuna kishte marrë vendim për shpëputje të kontratës vetëm për njërin qiramarrës, derisa për shtatë të tjerë nuk ka ndërmarrë asnjë masë.

Rreziku Menaxhimi i dobët i kontratave në lidhje me pronat e dhëna me qira mund të rezultojnë me konkurrencë të limituar apo me më pak të hyra nga kjo kategori dhe trajtim jo të barabartë të palëve. Mungesa e kontrollit dhe mos aplikimi i masave adekuate pamundëson arkëtimin e të hyrave nga qiraja dhe rrit rrezikun e vjetërimit të kërkesave.

Rekomandimi 3 Kryetari i Komunës të sigurojë arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe në mënyrë aktive të shqyrtojë të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e dakorduara janë realizuar.

Çështja 4 - Mos kryerja e obligimeve (taksës) nga bizneset

E gjetura Në vetëm pesë raste të testuara identifikua se faturimi i taksave të biznesit ishte 170,450€, ndërsa pagesa për to ishte vetëm 40,000€, apo rreth 23% të shumës totale. Te arkëtueshmet e mbetura për vetëm këto pesë biznese ishte 130,450€. Me tutje identifikua se në vitin 2017, komuna nuk kishte trajtuar në mënyrë të barabartë të gjitha bizneset, përkatësisht njërit nga bizneset nuk i kishte lëshuar vërejtje për mos pagesë të borxhit.

Rreziku Mos efikasiteti në mbledhjen e të hyrave nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë dhe dobësitë në menaxhimin e tyre, duke mos ndërmarr masat ligjore, rrezikon që komuna të mos ketë bazë të mjaftueshme ligjore për të pretenduar ndaj të drejtës për inkasim të hyrave të parapara.

Rekomandimi 4 Kryetari duhet të sigurojë se barazimet rreth mbledhjes së të hyrave kryhen në baza të rregullta mujore dhe të ndërmerr të gjitha aktivitetet e nevojshme juridike për inkasim të taksës së biznesit.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MF. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve; dhe rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 14,586,347€, ndërsa ishin shpenzuar 14,514,631€, apo shprehur në përqindje rreth 99.5%.

Çështja 5 - Punësimi i 40 mësimdhënësve pa konkurs (shpallje publike)

E gjetura Sipas Ligjit të Punës, Neni 8, Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës. Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi.

Komuna kishte punësuar 40 mësimdhënës në arsim pa procedura të rekrutimit (pa shpallje publike), duke anashkaluar plotësisht kërkesat ligjore. Punësimi i tyre ishte bërë me vendim të Kryetarit i cili ishte bazuar në rekomandimin e Drejtorit i Arsimit.

Rreziku Punësimi pa procedura të rekrutimit, nuk siguron konkurrencë dhe transparencë dhe shton rrezikun për përzgjedhjen e kandidatëve pa shkathtësitë dhe përvojat e duhura profesionale

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime të menjëhershme për ta shqyrtuar këtë proces të punësimit, si dhe të sigurojë kontrolle efektive në mënyrë që proceset e rekrutimit të bëhen në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit të punës.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 3,405,636€. Prej tyre ishin shpenzuar 3,263,313€ apo 96% nga buxheti i ndarë për këtë kategori. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet komunale, shërbimet kontraktuale, mirëmbajtja rregullt, etj.

Në vijim kemi prezantuar dobësitë në menaxhimin e mallrave dhe shërbimeve.

Çështja 6 - Pranimi i mallrave pa komision

- E gjetura** Komuna nuk kishte kontrolle të mira më rastin e pranimi të mallrave dhe shërbimeve. Furnizimi më lëndë djegëse dru "Ahu" në vlerë 8,055€, ne nuk kemi hasur në ndonjë dëshmi se pranimi i mallrave ishte bërë me komision. Për me tepër zyrtarët e arsimit nuk kanë ofruar ndonjë shpjegim rreth pranimi të tyre.
- Rreziku** Pranimi i mallrave në mungesë të komisionit rritë rrezikun që mallrat/shërbimet e pranuar të mos plotësojnë kërkesat e përcaktuara me kontratë përfshirë sasinë dhe cilësinë e tyre.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të siguroj që para pranimi të mallrave ose shërbimeve të formoj komision për pranimin e tyre. Me tutje të sigurojë se për secilën lëndë të ekzistojnë dëshmi sipas të cilave komisioni ka verifikuar nëse mallrat dhe shërbimet e pranuar janë në pajtim me kontraktimet për to.

Çështja 7 - Mungesa e raportit për shërbimet e kryera dhe mos ndalja e tatimit

- E gjetura** Gjatë testimit të tri kontratave për shërbime të veçanta, në vlerë totale 2,071€, komuna nuk kishte të bashkangjitur raport (dëshmi) për punët e kryera, të arsyetuara nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Për më tepër pagesat janë bërë të plota duke mos aplikuar ndaljen e tatimit në burim.
- Rreziku** Në mungesë të monitorimit të mjaftueshëm dhe raporteve për punët apo aktivitet e kryera, ekziston rreziku që shërbimet mos të përfundohen në përputhje me kushtet e kontraktuara. Derisa në mungesë të ndaljes së tatimit ekziston rreziku për ndëshkime nga organet kompetente (Administrata Tatimore e Kosovës).
- Rekomandimi 7** Kryetari i Komunës duhet të siguroj, që para se të behën pagesat bazuar në kontratat për shërbime të veçanta, të ketë raport punë të nënshkruar nga mbikëqyrësit e autorizuar. Me tutje të sigurojë se për të gjitha kontratat për shërbime të veçanta, ndalet tatimi në burim në përputhje me legjislacionin.

3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 660,746€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 659,626€, apo 99% te buxhetit. Subvencionet dhe transferet ishin menaxhuar në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 9,686,186€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 8,620,886€, apo 89% nga buxheti final. Ato kanë të bëjnë me ndërtimi i rrugëve lokale më vlerë prej 4,483,705€ apo 52%, kanalizimet më 1,003,812€ apo 12%, objektet arsimore më 418,170€ apo 5%, kompensimet për shpronësimet 350,510€, apo 4%, avanset për investime prej 277,230€ apo 3% dhe shpenzimet tjera.

Komuna e Ferizajt në vitin 2017 ka zhvilluar 181 aktivitete të prokurimit dhe vlera e kontratave të lidhura arrin shumën 18,791,773€. Në këtë raport të kontratave të nënshkruara përfshihen edhe kontrata dy dhe tri vjeçare.

Çështja 8 - Tejkallim i vlerës së kontratës në raport me kornizën buxhetore për projekte

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Nga testimi i procedurave të prokurimit të tenderit për ndërtimin e shkollës së mesme në Ferizaj, kontratë tri vjeçare, nr. 175 e dt.20.11.2017 në vlerë 1,803,727€, nuk ishte respektuar korniza buxhetore për projekte kapitale. Sipas kornizës buxhetore për projekte kapitale vlera e përcaktuar për këtë projekt për tri vite ishte 570,000€, me diferencë 1,233,726€. |
| Rreziku | Kontraktimi i projekteve në vlera shumë me të larta në raport me kornizën buxhetore të investimeve kapitale rritë rrezikun për rritjen e obligimeve kontraktuale të cilat me pas mund të shkaktojnë vështirësi financiare për komunën. |
| Rekomandimi 8 | Kryetari duhet të sigurojë që të para se të lidhe kontrata, kryesisht ato afatgjata të sigurojë se ka fonde të mjaftueshme për mbulimin e tyre. |

Çështja 9 - Pagesa e faturave duke e shfrytëzuar buxhetin e projekteve tjera

E gjetura Komuna nuk kishte kontrole të mjaftueshme në realizimin e pagesave. Në dy projekte kemi identifikuar se ata për kryerjen e obligimeve kanë shfrytëzuar mjetet nga projektet tjera, si:

- Pagesa në vlerë 25,862€ për “Riparimin e rrjetit të kanalizimit fekal” ishte realizuar nga projekti “Asfaltimi i rrugës në Zllatar”; dhe
- Pagesa në vlerë 37,512€ për “Kanalizim në fsh. Dermjak” ishte realizuar nga projekti “Rregullimi i qendrës së qytetit faza e dytë”.

Ne nuk kemi vërejtur ndonjë vendim nga Kuvendi Komunal për aprovimin e ndryshimeve në buxhet.

Rreziku Menaxhimi, respektivisht ndryshimet në realizimin e projekteve kapitale mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave vjetore dhe strategjike të komunës dhe/apo pamundësinë e mbulimit të detyrimeve me fondet aktuale.

Rekomandimi 9 Kryetari, fillimisht duhet të siguroj që ekziston një plan i qartë për projektet që priten të realizohen, përfshirë buxhetin e përafërt për realizimin e tyre, e më pas pagesat të bëhet bazuar në buxhetin e aprovuar për to. Në rast të nevojave për ndryshime në buxhet, paraprakisht duhet të merret vendimi nga kuvendi komunal, në përputhje me nenin 18, Ligji mbi Buxhetit.

Çështja 10 - Pagesë jashtë llogarisë së operatorit kontraktues

E gjetura Në tri pagesa kemi vërejtur se komuna nuk kishte realizuar pagesat në llogaritë e Operatoreve Ekonomik (OE) më të cilët kishte kontratë, si:

- Projektin “Asfaltimi i rrugës në Rakaj” në vlerë 76,367€;
- Projektin “Asfaltimi i rrugës Milan Shuflaj” në vlerë 30,000€; dhe
- Projektin “Ndërtimi i shtigjeve për biçikleta në vlerë 84,855€.

Kjo ishte bërë në bazë të një marrëveshje në mes OE që kishin kontratë me Komunën dhe OE-ve tjerë që nuk kishin kontratë me komunën.

Rreziku Pagesa e faturës nga ana e komunës OE-ve për te cilët nuk ka kontratë mund të ketë rrezik që punë kryerësi të ju shmanget obligimeve tatimore.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të siguroj kontrole shtesë në sektorin e financave në mënyrë që pagesat t’i behën në përputhje të plotë me kontratën, në llogaritë e OE-ve që kanë kontratë të lidhur me komunën.

3.7 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 11 – Dobësi në menaxhimin e kontratave

- E gjetura** Në katër projekte kapitale, kemi vërejtur se komuna nuk kishte përgatitur një plan për menaxhimin e kontratave, kërkesë e Ligjit të Prokurimit Publik.
- Gjithashtu, te kontrata për mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore të shkollave të Komunës së Ferizajt kemi identifikuar se nuk ishte caktuar organi mbikëqyrës i punimeve. Sipas deklaratave të zyrtarëve të drejtorisë së arsimit pranimin e punimeve për mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore e kishin bërë punëtorët mirëmbajtës të shkollave përkatëse.
- Rreziku** Mos plotësimi i planit të menaxhimit të kontratës siç parasheh Ligji i Prokurimit mund të sjell pasoja për obligimet e ndërsjellët në mes të Komunës dhe – OE - Menaxherit të kontratës. Ndërsa, në mungesë të organit mbikëqyrës ekziston rreziku që projektet të mos realizohen në përputhje me kushtet e kontraktuara.
- Rekomandimi 11** Kryetari duhet të sigurojë se për secilin projekt/kontratë të lidhur të paraprakisht të përgatisë një plan për menaxhimin e kontratave. Me tutje për secilin projekt duhet të caktohet një organ mbikëqyrës i cili përcjellë punimet gjatë gjithë procesit.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Gjatë vitit 2017 Komuna ka bërë një progres në aspektin e regjistrimit të pasurive në krahasim me vitin paraprak, megjithëse edhe me tutje regjistri kontabël i pasurive nuk është i plotë dhe i saktë. Mos regjistrimi i plotë i pasurisë është trajtuar tek pjesa e Theksimit të Çështjes në Opinion, ndërsa në vijim do të paraqiten disa çështje tjera, të cilat komuna do duhej t'i merrte parasysh në vitin 2017.

Çështja 12 - Mos përdorimi i E-pasurisë dhe mungesa e depos

E gjetura Rregullorja nr. 02/2013 thekson se pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël - SIMFK ndërsa pasuritë jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e - pasuria".

Komuna e Ferizajt nuk e përdorë sistemin "e-pasuria" për t'i regjistruar pasuritë jo financiare nën 1,000€ dhe stoqet. Po ashtu, zyrtari i pasurisë nuk ka një regjistër të përgjithshëm të kësaj pasurie. Duke pasur parasysh mungesën e një depoje, ne kemi vërejtur se komuna nuk aplikon një sistem të hyrje/daljeve të materialit për zyrë. E vetmja mënyrë të cilën e aplikon komuna është aprovimi i kërkesës për çdo drejtori, derisa zyrtari pranues vetëm i nënshkruan sasi të pranuar.

Rreziku Mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria, vështirëson menaxhimin adekuat të pasurisë dhe rrit rrezikun e gabimeve gjatë evidentimit të pasurisë si dhe përlllogaritjes manuale të zhvlerësimit. Kjo poashtu mund të rezultojë me mos përmbushje të kërkesave të kontabilitetit dhe raportimit financiar të pasurisë. Ndërsa mungesa e një depoje, rritë rrezikun që zyrtari për pranim të mos ketë evidencë të plotë mbi pranim/dorëzimin e mallit.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të sigurojë se ka marrë veprimet e nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që menaxhimi dhe raportimi i pasurisë të bëhet në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Me pas të sigurohen trajnimet e duhura për stafin e komunës të cilët do të përcaktohen përgjegjës për zbatimin e këtij sistemi. Gjithashtu të sigurojë një depo në të cilën fillimisht do të pranohet malli, e pastaj do të shkarkohet përmes fletëdaljeve.

3.9 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të komunës prezantojnë shuma të mjeteve që qytetarët dhe organizatat i detyrohen komunës për shërbimet, punët, mallrat apo pronat që i kanë përfituar nga komuna. Sipas shënimeve të prezantuara në PFV shuma totale e këtyre llogarive në fund të vitit 2017 ishte 8,060,640€. Pjesa më të madhe e të arkëtueshmeve ishte nga tatimi në pronë prej 6,609,110€, taksat e biznesit prej 1,152,640€ dhe qiraja nga shfrytëzimi i pronës publike prej 298,890€.

Çështja 13 - Rritja e vazhdueshme e të arkëtueshmeve të pa mbledhura

E gjetura Komuna nuk ka arritur të krijojë një sistem efektiv për mbledhjen e të hyrave të saj. Si rezultat po sfidohet me rritjen e vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme të cilat në fund të vitit 2017 ishin 8,060,640€. Në raport me vitin paraprak ato janë rritë për 1,072,410€, ose mbi 15% (llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2016 ishin 6,988,230€). Llogaritë e arkëtueshme janë kryesisht nga tatimi në pronë si dhe nga taksat e bizneseve.

Rreziku Mungesa e një strategjie për inkasimin më të mirë të të hyrave, ka rezultuar me rritjen e të arkëtueshmeve nga viti në vit. Prandaj, mos hartimi i një strategjie nga komuna për rritjen e inkasimit, në një shkallë më të lartë të të hyrave, ka ndikime drejtpërsëdrejti në realizimin e objektivave të përgjithshme të komunës, e në veçanti në realizimin e projekteve kapitale nga të hyrat.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të ketë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e këtij problemi, duke vendosur mekanizma efektiv për mbledhjen e të arkëtueshmeve. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave ligjore për mbledhjen e tyre.

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 4,477,460€, kurse në vitin 2016 ishin 1,038,129€ që rezulton një trefishim të tyre. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna.

Më poshtë janë listuar mangësitë e identifikuar:

Çështja 14 -Mungesa e dokumentacionit të obligimeve të pa paguara

- E gjetura** Komuna nuk kishte arritur të menaxhoj dhe dokumentojë plotësisht të gjitha obligimet e papaguara. Nga 58 mostrat e testuara nga raporti i obligimeve të papaguara, në pesë prej tyre komuna nuk ka mundur të na sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm për auditim. Vlera totale e tyre ishte 125,000€. Mos ofrimi i dokumenteve për auditim paraqet kufizim në fushëveprim.
- Rreziku** Mungesa e dëshmive lidhur me obligimet e papaguara paraqet rrezik për paqartësi lidhur me obligimet e prezantuara, rrezik për konteste gjyqesore si dhe humbje financiare për komunën.
- Rekomandimi 14** Kryetari i komunës duhet të siguroj kontrolle shtesë në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve. Fillimisht secila faturë e pranuar duhet të regjistrohet në librin e faturave të pranuar. Pastaj për secilin muaj të raportohen faturat e papaguara. Me tutje komuna duhet të posedojë evidenca dhe dëshmi të plota për obligimet e papaguara.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të komunës ka rezultuar në 29 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, pesë (5) rekomandime janë zbatuar dhe 24 nuk janë zbatuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 15 rekomandime, dhe në vitin 2017, shtatë (7) nga to ishin zbatuar, dy (2) rekomandime tjera ishin në zbatim e sipër dhe gjashtë (6) nuk janë adresuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shiheni shtojcën II.

Çështja 15 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake

E gjetura Mungesa e një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, ka ndikuar që një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve janë mbetur në proces të zbatimit ose nuk janë zbatuar, përfshirë këtu edhe rekomandimet nga vitet paraprake. Kjo tregon një mungesë të përqendrimit të personave përgjegjës në aplikimin e masave konkrete lidhur me adresimin e këtyre rekomandimeve, që vijnë si rezultat i dobësive të identifikuara në komunë.

Rreziku Mos adresimi i shumicës së rekomandimeve të dhëna shton rrezikun që të vazhdojë përsëritja e dobësive të njëjta në sistemet kryesore të komunës. Mos adresimi i kërkesave për përmirësime dhe përsëritja e rekomandimeve rezulton në mos efikasitet të vazhdueshëm dhe humbje financiare për Komunën.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm në lidhje me zbatimin e rekomandimit, nuk janë të vendosura. Nuk ka raporte cilësore të përgatitura nga prokurimi në lidhje me realizimin e kontratave të nënshkruara dhe krahasimin e tyre me planifikim të prokurimit. Mungesa e raporteve për menaxhmentin nga zyra ligjore për detyrimet kontingjente. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces jo të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në Komunë është e themeluar Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) e cila operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NJAB-së dhe dy auditor. Përveç Planit strategjik, NJAB kishte hartuar edhe Planin vjetor të punës ku ishin përfshirë disa auditime për vitin 2017. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Çështja 16 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm

- E gjetura** Nga 12 auditimet e planifikuara, 11 prej tyre ishin realizuar gjatë vitit 2017. Raportet e kryera përfshinin periudhën e vitit 2016 dhe pjesërisht të vitit 2017. Komiteti i auditimit (KA) sipas kërkesave ligjore deri më tani ka mbajtur tri mbledhje të rregullta, ku nder të tjera ishte shqyrtuar raporti përmbledhës i NjAB për vitin 2016. Gjatë vitit 2017 ishin dhen 35 rekomandime nga NjAB-i. Nga 31 rekomandimet të cilat sipas planit duhet të zbatoheshin gjatë vitit 2017 (katër sipas planit pritet të zbatohen gjatë vitit 2018), vetëm katër prej tyre ishin zbatuar, katër të tjera ishin në proces, ndërsa 23 nuk janë zbatuar.
- Rreziku** Mos zbatimi i rekomandimeve do të ndikojë drejtpërdrejtë në efektivitetin dhe efikasitetin e kontrolleve të brendshme në organizatë dhe vazhdimin e dobësive të njëjta.
- Rekomandimi 16** Kryetari duhet të punojë me gjithë varësit e vet, për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm. Kryetari duhet të forcoj edhe më shumë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 17 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut**E gjetura**

Si pasojë e kontrolleve të dobëta menaxheriale, shuma të konsiderueshme të buxhetit për investime kapitale janë paguar për mallra dhe shërbime. Procedurat e prokurimit të filluara pa u bazuar në kornizën buxhetore, vlerësimi i dobët i nevojave, mbikëqyrja e pamjaftueshme dhe mos pagesa e obligimeve me kohë, nuk ishin trajtuar mjaftueshëm nga ana e menaxhmentit. Si rezultat i kësaj, disa prej projekteve as që kanë filluar, ndërkohë që disa kontrata janë subjekt i shqyrtimeve gjyqësore. Menaxhmenti nuk posedon analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, nuk rishqyrton planin e prokurimit dhe nuk ka raporte të rregullta për aktivitetet operative të realizimit të kontratave.

Komuna, gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe as që përgatitet ndonjë raport për menaxhimin e tyre.

Rreziku

Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 17 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4 Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për mos adresimin e rreziqeve domethënëse lidhur me keqklasifikimin e shpenzimeve dhe plotësinë e pasurive e që ka rezultuar me Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime shtesë për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të siguruar një vlerësim të saktë të pasurive kapitale. Ky proces duhet të monitorohet formalisht nga Kryetari.		Vetëm pjesërisht është zbatuar ky rekomandim ngase edhe në këtë vit ka pasur keq-klasifikime të shpenzimeve	
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.			Nuk janë marrë masa.
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe se rreziqet janë nën kontroll.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2016.			Nuk janë marrë masa.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore për investime kapitale monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.	Po		
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të sigurojë se do të bëhet një rishikim i këtyre gjetjeve të auditimit në të cilat proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive, si dhe të aplikoj me shumë kontrolle si në rastet e pagesave dhe të kërkoj mbajtjen e dëshmive të udhëtimit bazuar në agjendat paraprake.	Po		
	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha njësitë kërkuese me rastin e planifikimit të shpenzimeve të kryejnë analiza të plota sepse një planifikim jo i mirë mund të sjellë një konkurrencë jo të mirëfilltë nga ofertuesit, dhe paraja publike të mos shpenzohet në mënyrë racionale.	Po		
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të siguroj se marrëveshjet realizohen ashtu siç palët janë dakorduar paraprakisht dhe subjekti i marrëveshjes është baza mbi të cilën kryhen të gjitha pagesat e më vonshme. Të gjitha pagesat duhet të bëhen vetëm pas kryerjes së shërbimeve dhe pagesat në avance duhet të ndërpriten pasi përmbajnë elemente të pagesave të parregullta. Kontrollat e monitorimit të këtyre marrëveshjeve duhet të aplikohen që nga inicimi deri në realizimin e plotë të këtyre marrëveshjeve për të parandaluar pagesat për mallra dhe shërbime nga buxheti për investime kapitale dhe raportet e plota duhet të dokumentojnë arsyeshmërinë dhe rregullsinë e këtyre shpenzimeve.	Po		

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet t'i forcojë kontrollet me rastin e shpenzimeve për dreka zyrtare. Të gjitha shpenzimet për dreka zyrtare duhet të jenë në funksion të mirëfilltë të përfaqësimit dhe shërbejnë për arritjen e objektivave të komunës. Kryetari duhet ta inicioj hartimin e një procedure e cila përcakton limitet e lejuara dhe rregullat me rastin e shpenzimeve për dreka zyrtare.	Po		
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari duhet të rishikoj funksionimin e kontrollit të listës së pagave dhe të analizojë arsyet që i kanë shkaktuar këto parregullsi të identifikuara. Kryetari duhet të sigurojë që të forcohen kontrollet e listës së pagave për të mundësuar aplikimin efikas të rregulloreve relevante.	Po		
3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të sigurojë se dhënies së subvencioneve për entitetet publike apo individuale do t'i paraprijnë kriteret dhe procedura të qarta që përputhen me objektivat e komunës. Kontrollet lidhur me këto kritere dhe procedura, duhet të zbatohen dhe monitorohen duke kërkuar dëshmitë e parapara.	Po		
3.6 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari të sigurojë një vlerësim detal për mos funksionimin me kohë të mekanizmave për të inkasuar borxhet, sidomos atyre të pronës publike. Po ashtu, do të ishte e rëndësishme të analizohet pse kontrollet kanë dështuar lidhur me inspektimet në terren, si dhe nga personat përgjegjës të kërkoj veprime të menjëhershme për shqyrtimin e rasteve të përmendura.			Nuk janë marrë masa.
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Kryetari duhet të siguroj se procesi i regjistrimit të pasurisë dhe vlerësimit/tjetërsimit të bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi, për t'ju shmangur rreziqeve të keqmenaxhimit, keqpërdorimit dhe ruajtjes jo adekuate të pasurive të komunës.		Përkundër progresit lidhur me regjistrimin e pasurive, ende nuk është e arritur që pasuritë e komunës të jenë plota.	

3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	trajtimin e këtij problemi, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për reduktimin në nivel të pranueshëm të këtyre borxheve. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumëve domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative.			Nuk janë marrë masa.
3.7.3 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të siguroj një planifikim të kujdesshëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve të bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkaluar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike. Gjithashtu, të kërkoj më shumë përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës që me rastin e planifikimit të buxhetit, të merret parasysh edhe koha e likuidimit të obligimeve.			Nuk janë marrë masa.
Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2016	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.3 Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së Opinionit. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i evituar gabimet në keq klasifikimin e shpenzimeve dhe mos regjistrimin e saktë të pasurive. Gjithashtu, duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshëm.			Nuk janë marrë masa.

1.3 Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike.			Nuk janë marrë masa.
2 Qeverisjes se mirë	Kryetari duhet të sigurojë se është rishikuar plotësimi i listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Ne do të sugjerim që lista kontrolluese të mos i dorëzohet MF-së para se të rishikohet nga auditimi i brendshëm.			Nuk janë marrë masa.
2 Qeverisjes se mirë	Kryetari duhet hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes. Të sigurojë se plani i përpiluar kundër korrupsionit do të zbatohet sipas kërkesave, dhe si i tillë do të bëhet funksional për një qeverisje më efektive.			Nuk janë marrë masa.
2 Qeverisjes se mirë	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2017.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Auditimi i brendshëm	Kryetari duhet të siguroj ndërmarrjen e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të NjAB nga drejtoritë përgjegjëse të sistemeve të audituara, dhe po ashtu, të siguroj se Komiteti i auditimit i respekton kërkesat ligjore për raportimin vjetor.			Nuk janë marrë masa.

3.1.5 Investimet kapitale	7.Kryetari duhet të siguroj dhe të përcaktoj objektiva të qarta për përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në periudhat e ardhshme, dhe të vendosë një monitorim sistematik mbi ekzekutimin e buxhetit të planifikuar, sidomos për projektet kapitale.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Te hyrat	Kryetari duhet të ndërtoj mekanizëm kontrolli në mënyrë që të parandaloj gabimet. Po ashtu, të kërkojë nga zyra për tatim në pronë një përkushtim më të madh në rastin e ngarkesave si dhe të kërkojë raporte periodike me informata të sakta dhe të besueshme.	Po		
	Kryetari duhet të analizoj shkaqet për inkasim kaq të ulët dhe të krijoj mekanizma për rritjen e inkasimit. Duhet, po ashtu, të siguroj se interesi në vonesa për ngarkesën e taksës në firmë zbatohet ndaj të gjithë debitorëve.			Nuk janë marrë masa.
	Kryetari duhet të analizoj performancën e dobët të kontrolleve lidhur me inspektimet në terren dhe të siguroj se kontrollet në zbatimin e lejeve ndërtimore do të aplikohen, si dhe të përgatiten raporte për punët e kryera nga zyrtarët përgjegjës.			Nuk janë marrë masa.
	Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidencë për të gjitha të hyrat dhe se rastet e liruara nga obligimi i pagesës së taksave të prezantohen veçmas në një evidence të veçantë.	Po		
	Kryetari i Komunës duhet ta shqyrtoj rastin pse qiraja e kontraktuar nuk po paguhet, si dhe ta informoj Kuvendin për problemet eventuale me qiramarrësin. Pasi të sigurojë një analizë të detajuar, të propozoj masat e duhura, duke mos i përjashtuar edhe masat gjyqësore dhe ato administrative (nëse ka nevojë).			Nuk janë marrë masa.

3.1.2 Pagat dhe Mëditje	Kryetari duhet të sigurojë që të gjithë të punësuarit paguhen nga fondet e pagave të drejtorive përkatëse, respektivisht kodeve adekuate, si dhe të punësuarit evidentohen me kohë në sistemin e pagave.	Po		
3.1.3 Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët financiar do të kenë aplikojnë kontrolle të shtuara si dhe mbajnë evidenca të sakta për të gjitha obligimet e pritura, të verifikojnë se cilës periudhë i takon borxhi i faturuar, dhe në rastin konkret, të bëjnë barazimin e faturave me pagesat e komunës ndaj kompanisë në fjalë.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë se para fillimit të procedurave të prokurimit, zyrtarët përgjegjës marrin parasysh kërkesat dhe nevojat reale të komunës. Artikujt të cilët nuk do të jenë subjekt furnizimi, nuk duhet të përfshihen në dosjen e tenderit.	Po		
3.1.3 Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë se mbajtja e tatimeve në burim për personat e angazhuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta është në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të shtojë kontrollet dhe sigurojë se pagesat bëhen vetëm pasi të konfirmohet se shërbimet e faturuara janë kryer nga ana e operatorit, si dhe të sigurohet paraprakisht se fondet buxhetore janë në dispozicion dhe të parashikuara me planin vjetor.			Nuk janë marrë masa.
	Kryetari duhet të sigurojë se drejtorja e shërbimeve publike dhe emergjencës do të përgatitë raporte mujore për të gjitha aktivitetet e kryera në mënyrë që shpenzimet e ndodhura të jenë të justifikueshme me shërbimet e kryera.			Nuk janë marrë masa.

	Kryetari duhet t'i forcojë kontrollet me rastin e shpenzimeve për dreka zyrtare. Të gjitha shpenzimet për dreka zyrtare duhet të jenë në funksion të mirëfilltë të përfaqësimit dhe shërbejnë për arritjen e objektivave të komunës. Po ashtu, duhet të sigurohet se obligimet paguhen brenda 30 ditëve.			Nuk janë marrë masa.
	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha shpenzimet regjistrohen në kategoritë përkatëse, në këtë mënyrë do të sigurojë prezantim të saktë dhe pasqyrë të qartë të shpenzimeve.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit zbaton të gjitha rregullat e prokurimit duke pasur parasysh se mos respektimi i tyre mund të ndikoj në mos arritjen e objektivave të komunës për projektet kapitale, apo mund edhe të rezultojë mos humbje financiare.			Nuk janë marrë masa.
	Kryetari duhet të kërkojë përgjegjësi ndaj zyrës së prokurimit për mos zbatimin e rregullave të prokurimit dhe të sigurojë se në rastet e tilla kur një operator terhiqet nga tenderimi, të konfiskohet sigurimi i tenderit nga komuna.	Po		
3.1.3 Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të shqyrtoj pse pagesa e tillë ka ndodhur, dhe të sigurojë se zyrtari certifikues nuk certifikon asnjë pagesë në llogari jo përkatëse, apo që nuk është pjesë e kontratës, dhe se raste të tilla nuk përsëriten.			Nuk janë marrë masa.
	Kryetari duhet të siguroj se shërbimi i prokurimit do t'iu përmbahet në mënyrë strikte kërkesave të LPP dhe jo të ndryshoj kushtet dhe kriteret e dosjes së tenderit të cilat me rastin e anulimit të tenderit të parë, nuk ishin theksuar si arsye për anulimin e procesit. Kryetari duhet të vendos kontrolle të forta në fushën e prokurimit dhe të mundësoj një proces transparent dhe konkurrues të prokurimit, në mënyrë që të maksimizoj vlerën për para.			Nuk janë marrë masa.

	Kryetari duhet të eliminoj rrezikun që paraja publike të shpenzohet në mënyrë jo të duhur dhe të sigurojë se pagesat e tilla monitorohen nga zyrtarët financiar dhe se asnjë pagesë nuk ekzekutohet pa pranuar raporte për aktivitetet e kryera.			Nuk janë marrë masa.
	Kryetari duhet të përmirësoj procesin e planifikimit dhe të sigurojë monitorim të këtyre marrëveshjeve që nga inicimi deri në realizimin e plotë të tyre për të parandaluar pagesat për mallra dhe shërbime nga buxheti për investime kapitale.			Nuk janë marrë masa.
3.2.1 Pasuria kapitale dhe jo kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se e-pasuria është funksionalizuar apo regjistrimet e pasurisë në përdorim të mbahen ndonjë formë tjetër, si dhe caktimi i një depoje ku personi përgjegjës do të deponoj mallin dhe do mbajë evidenca për të gjitha hyrje/daljet e materialit për zyrë, duke zvogëluar kështu mundësinë për manipulime të mundshme.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Llogarit e arkëtueshme	Kryetari duhet të ketë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e këtij problemi, duke vendosur mekanizma efektiv për reduktimin e këtyre borxheve. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).			Nuk janë marrë masa.
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë një planifikim të kujdesshëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve të bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkaluar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike. Gjithashtu, të kërkojë më shumë përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës që pagesat e obligimeve të kryhen brenda afateve ligjore.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letërkonfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Ferizajt, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Agim Aliu

Kryetar i Komunës,

Data: 08.Maj.2018, Ferizaj,

